

# Vështrim mbi #Filantropinë

**BULETIN 3 MUJOR Nr. 7, dhjetor 2019**

## Tragjedia e 26 nëntorit 2019



Tërmeti i 26 nëntorit që goditi rajonin e Durrësit dhe Tiranës, ishte një nga tërmetet më të fuqishëm, që ka goditur ndonjëherë vendin tonë.

Partnerët Shqipëri, nëpërmjet monitorimit ditor të situatës, ka mundur të identifikojë disa dinamika në lidhje me dhurimet, kanalet dhuruese, dhuruesit dhe platformat e përdorura.

**Artikulli i plotë në Faqen 8**

Për të pestin vit radhazi Partnerët Shqipëri po kryen monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale, si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike. Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve. Nëpërmjet këtij buletini Partnerët Shqipëri prezanton të dhëna infografike mbi monitorimin e këtij aktiviteti, si dhe rastet e mbështetjes dhe dhurimit, në Shqipëri dhe rajon.

### FAQE 2-5

Fakte mbi Aktivitetin Filantropik në Shqipëri Tetor—Dhjetor 2019

### FAQE 6

Dita Botërore e "Fëmijëve Jetim"  
AlbChrome ndihmon gjimnazin e Bulqizës  
Një shërim i plotë për Erneston

### FAQE 7

Koncert bamirësie për gratë dhe vajzat e prekura nga kanceri i gjirit

### FAQE 8

"Shqipëria Solidare" nisma më e re në ndihmë të personave në vështirësi ekonomike.

### FAQE 9-10

Tragjedia e 26 nëntorit 2019


### FAQE 11

Infrastruktura e Filantropisë në Europë




Fakte mbi Aktivitetin Filantropik  
Tetor—Dhjetor 2019

## Numri i dhurimeve



- Publik i Gjerë-Zonë Specifike (48.1%)
- F&R-Pa Përkujdesje Prindërore (12.02%)
- Publik i Gjerë-Vështirësi Ekonomike (12.02%)
- Të rritur-Të moshuar (6.01%)
- F&R-Zonë Gjeografike Specifike (4.01%)
- Publik i Gjerë (4.01%)
- Të rritur-Probleme të Shëndetit Fizik (2%)
- F&R-Paafësi Intelektuale (2%)
- F&R-Paafësi Fizike (2%)
- F&R-Probleme të Shëndetit Fizik (1%)
- G&F-Viktima të Dhunës (1%)
- Të rritur-Paafësi Fizike (1%)
- F&R-Probleme të Shëndetit Mendor (1%)
- Të rritur-Prindër të vetëm (1%)
- Fëmijë&Te Rinjtë (1%)
- F&R-Komunitete Minoritare (0.3%)
- F&R-Të Talentuar (0.3%)
- G&F-Viktima të Trafikimit (0.3%)
- Të rritur-Të Pastrehë (0.3%)
- Të rritur-Probleme të Shëndetit Mendor (0.3%)
- F&R-Vështirësi Ekonomike (0.3%)

## Përfituesit përfundimtar



Rreth 48% e dhurimeve kanë shkuar në mbështetje të familjeve të prekura nga tërmeti i 26 nëntorit në rajonin e Durrësit dhe Tiranës. Solidarizimi nga vendi, rajoni dhe diaspora ishte absolut dhe i menjëhershëm. Individë, organizata të shoqërisë civile, dhe biznese dhuruan fonde, ushqime dhe veshmbathje për këto familje. Vullnetarë dhe epike shpëtimi apo ekspertë u dërguan në terren nga vende fqinje.


Një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe rrjetet sociale dhe platformat crowdfunding për adresimin e ndihmës ndaj personave të prekur nga kjo fatkeqësi natyrore. Platforma kryesore dhe gjithëpërfshirëse është portali qeveritar, e-Albania. Qindra fushata crowdfunding u krijuan, organizatorët e të cilave u shprehën se do ti shpërndajnë vetë dhurimet tek të prekurit nga tërmeti, ndërsa një pjesë zgjodhën ti kanalizojnë përmes organizatave jofitimprurëse, ku mund të përmendim: Kryqin e Kuq, Caritas, Fundjavë Ndryshe, Fondacionin Firdeus, etj.




## Qëllimi i dhurimit

- Fatkeqësi Natyrore (47.57%)
- Mbështetje e Grupeve të Marxhinalizuara (28.74%)
- Zbutja e Varfërisë (12.88%)
- Art&Kulturë (4.96%)
- Edukim (1.98%)
- Shëndetësi (1.98%)
- Infrastrukturë Publike (0.99%)
- Mjedisi (0.3%)
- Sport (0.3%)
- Miks (0.3%)


## Kanalet e dhurimit






## Vlera e dhurimeve sipas natyrës



## Forma e dhurimit





**F&R**—Fëmijë dhe të rinjtë

**Dhurime Sezonalë** – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

**Mix**—Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet.

**OJF**—Organizata Jofitimprurëse

**Publik i Gjere**—Një grup i vogël apo i madh njerëzish

**G&F**—Gra dhe Fëmijë

**Ndihmë Ekonomike**—Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë me vështirësi ekonomike apo gjatë fatkeqësive natyrore.

**NVM**—Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme

**Zonë Specifike**—Zonë Gjeografike Specifike

## AlbChrome

### *ndihmon gjimnazin e Bulqizës*

Falë AlbChrome, gjimnazi "28 Nëntori" në qytetin e Bulqizës është pajisur me laborator Informatike. Këtij laboratori iu shtuan 13 kompjutera të rinj.

Albchrome i erdhi në ndihmë me bazë materiale edhe Çerdhes nr. 2 në Burrel, duke përmirësuar kështu kushtet për foshnjat që rriten çdo ditë aty, duke e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për përdorimin e përditshëm.



Burimi: Balfin | GazetaTema

## Një shërim i plotë

### *për Erneston*

Ernesto 11 vjeçar vuante nga sëmundja e vështirë e tumorit ne kocke çka përbënte një sfidë shpirtërore dhe ekonomike për një familje në vështirësi si e tij.

Spitali Amerikan dhe Dr. Klodian Allajbeu morën përsipër kujdesin mjekësor ndaj tij falas.

Prof. Dr. Kamil Kose ka kryer ndërhyrjen delikate që i ka shpëtuar jetën Ernestos dhe si pasojë gjuri i pacientit të vogël do të funksionojë normalisht.



Burimi: Spitali American

## Një ditë e veçantë

### *Për fëmijët pa përkujdesje prindërore*



Tragjikisht miliona fëmijë në të gjithë botën janë jetimë për shkak të ndryshme. Dita Botërore e Jetimëve është një ditë e veçantë që i dedikohet këtyre fëmijëve dhe publiku i gjerë ndërgjegjësohet për sfidat, me të cilat hasen fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë në bashkëpunim me ambasadën e Egjiptit në Shqipëri organizuan në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar një event të përbashkët bamirësie, ku u ekspozuan nëpër stenda një sërë objektesh artistike me vlera të veçanta, punime artizanale dhe piktura me një stil të veçantë.

Të ardhurat e grumbulluara nga shitja e tyre, shkuan në mbështetje të fëmijëve jetim në Shqipëri.


Burimi: eksperimentmeveten.com



**11 VJET**  
KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

## ERMONELA JAHO

AMBASADORE E YWCA PËR KAUZËN E *Fiangas Rozë*



“Fjongoja Rozë”  
*më kujton...*



U.S. EMBASSY  
Tirana, Albania



CREDINS bank



Sopranoja shqiptare me famë ndërkombëtare Ermonela Jaho, së bashku me Vikena Kamenicën dhe balerinën Enada Hoxha performuan në një koncert bamirësie në emër të të gjitha grave dhe vajzave të prekura nga kanceri i gjirit.

Prej dy vitesh Ermonela Jaho është ambasadore e fushatës kundër kancerit të gjirit. Koncerti nën moton “Fjongoja Rozë” më kujton”, është pritur me shumë interes nga publiku dhe të ardhurat e grumbulluara nga ky koncert kanë shkuar për këtë kauzë.

# #ShqipëriaSolidare

Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me sipërmarrësit e mëdhenj të Shqipërisë, u ka kërkuar të bëhen pjesë e një mekanizimi për t'u ardhur në ndihmë njerëzve të varfër të Shqipërisë.

“Shqipëria Solidare” është emri i fondit të nisur nga qeveria në bashkëpunim me biznesmenët. Secilit prej biznesmenëve do t'ju bjerë një barrë e barabartë, e cila mund të jetë 2% mbi dividendin e tyre. Mekanizimi nuk do të kontrollohet nga qeveria, por nga vetë biznesmenët. Qëllimi i kësaj nisme është të ndihmohen njerëzit në vështirësi ekonomike.

*“Ambicia nuk është të krijojmë thjeshtë një rreth të mbyllur, por të krijojmë me biznesin e madh bërthamën e një lidërshipi kombëtar në emër të përgjegjësisë sociale dhe në funksion të Shqipërisë solidare” deklaroi kryeministri Rama gjatë takimit.*







# Tragjedia *e 26 Nëntorit 2019*



Tërmeti i 26 nëntorit që goditi rajonin e Durrësit dhe Tiranës, ishte një nga tërmetet më të fuqishëm që ka goditur ndonjëherë vendin tonë. Në vazhdë të kësaj tragjedie, solidarizimi ka qënë absolut dhe i menjëhershëm. Partnerët Shqipëri nëpërmjet monitorimit ditor të situatës ka mundur të identifikojë disa dinamika në lidhje me dhurimet, kanalet dhuruese, dhuruesit dhe platformat e përdorura.

Shqiptarët e Ballkanit gjithashtu treguan një koordinim dhe solidarizim impresionues, në veçanti shqiptarët e Kosovës që ishin të parët që iu përgjigjën thirrjes për ndihmë urgjente. Krahas ndihmave në fonde, ushqime dhe veshmbathje, vullnetarë dhe ekipe shpëtimi apo ekspertë u dërguan në terren nga vende si: **Italia, Greqia, Rumania, Serbia, Zvicra, Franca** dhe **Izraeli**. Forcat e ushtrisë shqiptare, forcat speciale, zjarrfikëset si dhe emergjencat civile punuan së bashku në përpjekje maksimale për të gjetur jetë nën rrënoja.

Rrjetet sociale, portalet dhe platformat e ndryshme kanë luajtur një rol të rëndësishëm në adresimin e ndihmës ndaj grupeve në nevojë të prekura nga tërmeti. Platforma kryesore dhe gjithëpërfshirëse është portali qeveritar, e-Albania. Fushatat më të shumta janë realizuar përmes facebook dhe platformave crowdfunding si GoFundMe, JustGiving, Go Get Funding, Giving Balkans, Fundly, etj.

Kjo fatkeqësi natyrore demostroi solidarizim masiv dhe nxorri në pah tiparin e vullnetarizmin brenda dhe jashtë vendit. Përgjigjja e dhuruesve ndaj hashtag **#ActforAlbania** ishte e menjëherëshme mes Evropës, Amerikës së Veriut dhe Australisë. Mbi 89% e fushatave të dhurimit qënë nismë e Diasporës Shqiptare. Përpos kësaj, dhurimet erdhën nga çdo cep i globit.

Kjo tragjedi duket se i ka bashkuar shqiptarët më shumë se kurrë. Ndër fushatat e shumta të dhurimit, spikasin dhe ato të ngritura nga familjarë të personave që humbën të dashurit e tyre.

Shumë prej organizatorëve të këtyre fushatave janë shprehur se do ti shpërndajnë vetë dhurimet tek të prekurin nga tërmeti, ndërsa një pjesë kanë zgjedhur ti kanalizojnë përmes organizatave jofitimprurëse, ku mund të përmendim: Kryqin e Kuq, Caritas, Fundjavë Ndryshe, Fondacionin Firdeus, etj.

**Fundjavë Ndryshe, Fondacioni Firdeus** dhe **Rrënjët Shqiptare** janë deri më tani organizatat që kanë arritur të grumbullojnë më shumë të ardhura.

Në ditët që pasuan 26 nëntorin, pati një aktivizim të të gjitha strukturave shtetërore por jo vetëm. Krahas punës së admirueshme të bluzave të bardha dhe forcave të kërkim-shpëtimit, të gjithë dhanë kontributin e tyre sipas fushës së mbulimit.

Organizatat jofitimprurëse u angazhuan duke grumbulluar ushqime, veshje, batanije, dyshekë, materiale higjienike dhe duke ofruar ndihma mjekësore. Gjithashtu si pjesë e një ndërhyrjeje më të koordinuar në bashkëpunim me institucionet qeveritare dhe ato donatore, OJF-të ofruan shërbime të mbështetjes psikologjike dhe organizuan aktiviteteve rekreative për fëmijët, gratë dhe moshën e tretë pranë qendrave të akomodimit.

Një tragjedi e kësaj përmase ka qënë pa dyshim një sprovë e fortë për Shqipërinë, por pavarësisht të gjithave empatia, solidariteti dhe mbështetja nuk kanë munguar. Kjo na bën të shpresojmë në një rimëkëmbje të plotë dhe në një shërim të ngadaltë por të sigurtë të plagëve që shkaktoi kjo fatkeqësi natyrore.



**PEXforum.2020**

Philanthropy Europe Networks Forum

**IDS** | Philanthropy  
Infrastructure  
In Europe



**Alliance**  
For philanthropy and social investment worldwide

## Infrastruktura e Filantropisë

*në Europë*

Philanthropy Europe Networks Forum përfshin një numër të madh të organizatave kombëtare, rajonale dhe evropiane në mbështetje të filantropisë. Ky forum ofron një bazë të përbashkët për organizatat filantropike apo organizatat të përfshira në projekte filantropike. Hartëzimi i organizatave më të rëndësishme të filantropisë ofron një prezantim të qëllimeve, aktiviteteve dhe strukturave organizative të këtyre organizatave. Gjithashtu paraqet një mundësi të shkëlqyer për krijimin e rrjeteve dhe përvijimin e aktorëve kryesorë në fushën e filantropisë.

Philanthropy Europe Forum u krijua mbi bazën e DAFNE (Rrjetet e Donatorëve dhe Fondacioneve në Evropë) dhe është një event tejet i rëndësishëm vjetor i cili ofron një hapësirë për të diskutuar çështje aktuale, shkëmbim të njohurive, ndërgjegjësimin mbi tema të ndryshme dhe angazhimin e bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara. Philanthropy Europe Forum sjell sëbashku udhëheqës të fushës dhe ekspertë nga shoqatat kombëtare, forume të donatorëve dhe organizata mbështetëse të filantropisë.

Këtë vit ky event u mbajt për herë të parë në Madrid, Spanjë, më 23 janar dhe bashkoi rrjetet evropiane të filantropisë si dhe rrjetet tematike rajonale e globale. Format i tejet interaktiv i forumit siguroi shumë mundësi për angazhime aktive dhe rrjetëzime rajonale apo strategjike.

Link: <https://www.alliancemagazine.org/wp-content/uploads/2020/01/IDS-PEX2020-Forum.pdf>



Rruga e Elbasanit, Pallati Park Gate, Kati 10, Ap. 71/73, Kutia Postare 2418/1, Tiranë, Shqipëri.

Tel. Faks: **04 2254881**

Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)

<http://www.partnersalbania.org>